

VENDIM
Nr. 33, datë 10.4.2013

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregulator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit 179, datë 28.12.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshohet si më poshtë:

Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t’i shtrijë efektet deri në 31 maj 2013.

2. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani